

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2022

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar faktin se gjatë vitit 2022, bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizive u plotësua me të gjithë anëtarët e tij, duke zgjidhur një ngërç që ishte krijuar për një kohë relativisht të gjatë në punën e AMA-s;

Duke theksuar se ndryshimet ligjore në ligjin nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” janë një hap i rëndësishëm përpara në drejtim të përafrimit me direktivën e BE-së, veçanërisht në drejtim të rritjes së transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike, mbrojtjes së fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre, si dhe sigurimin e aksesit të “personave me aftësi të kufizuar”;

Duke konsideruar që një ndër objektivat kryesorë të AMA-s është që të gjitha shërbimet audiovizive të përmbushin sa më mirë nevojat e qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, duke respektuar gjuhën dhe larminë e traditave, besimet fetare, kulturën dhe moralin e qytetarëve, ruajtjen dhe mbështetjen e vlerave demokratike të përcaktuara në Kushtetutë dhe veçanërisht lirinë e shprehjes dhe të medias;

Vlerëson:

Bashkëpunimin e AMA-s me institucionet e tjera në hartimin e ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ndryshime të cilat bëjnë të mundur përafrimin e pjesshëm me Direktivën (BE) 2018/1808 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 nëntor 2018, si dhe ndër të tjera edhe rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike.

Punën e bërë nga AMA për finalizimin me sukses të procesit të koordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti të Planit të ri Frekuencor (470-694 MHz), si dhe mundësimin të operimit të rrjetit të shtatë në Shqipëri, duke përmbushur objektivin për trajtim dhe qasje të barabartë për të 7 operatorët audiovizivë kombëtarë në operim (publik/privat).

Punën e bërë nga AMA për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme lokale gjatë muajit mars 2022 në disa bashki në vend.

Punën e bërë nga AMA gjatë vitit 2022 në organizimin e konferencave dhe tryezave të ndryshme konsultuese për rishikimin e Kodit të Transmetimit me grupet e interesit, përfaqësues të autoriteteve homologe, ekspertë të botës akademike dhe medias, përfaqësues nga OJF-të.

Bashkëpunimin e AMA-s me AKEP-in në inspektimet e kryera në lidhje me fenomenin e piraterisë, si dhe punën e bërë në lidhje me fenomenin tjetër që po haset në këtë periudhë, atë të shtimit të numrit të operatorëve piratë, që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme, që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.

Përpjekjet e AMA-s për bashkërendimin e punës midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve më të mira teknike lidhur me problematikën e heqjes nga shtyllat elektrike të kablllove të operatorëve kabllorë.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 rekomandon:

1. Në zbatim të ndryshimeve ligjore të miratuara në lidhje me transparencën e pronësisë së mediave, AMA të marrë të gjitha masat që Ofruesit e Shërbimeve Mediatike Audiovizive (OSHMA) të bëjnë publik informacionin në lidhje me strukturën e tyre të pronësisë, duke përfshirë edhe pronarët përfutues, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Të ndjekë me rigorozitet zbatimin nga ana e Ofruesve të Shërbimeve përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligjin e ri të miratuar, veçanërisht ato të cilat lidhen me mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor apo moral të tyre, sigurimi i aksesit të “personave me aftësi të kufizuar” etj.

3. AMA të marrë masat e nevojshme për caktimin e një pike kontakti në faqen e saj zyrtare, lehtësisht të arritshme nga personat me aftësi të kufizuar, për dhënien e informacionit dhe marrjen e ankesave në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me aksesin në shërbimet e ofruara nga OSHMA-të për personat me aftësi të kufizuar.

4. AMA duhet të jetë më aktive dhe reaguese në rastet e kanosjeve dhe sulmeve kundër gazetarëve, si dhe në rastet e kërcënimeve ndaj medias ngado që ato vijnë.

5. AMA të luajë një rol aktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e grupit ndërinstitucional të punës për lirimin e brezit digjital divident dy (DD2); lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

6. Pas përfundimit të procesit të këshillimit publik, AMA të shqyrtojë me seriozitet komentet dhe sugjerimet nga të gjithë aktorët dhe faktorët për të bërë të mundur që Kodi i ri i Transmetimit të jetë sa më në koherencë me sfidat dhe zhvillimet në fushën e medias dhe më tej të vijojë me miratimin e tij.

7. Në kushtet kur problemi i mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave prej vitesh nuk po merr zgjidhje, AMA në bashkëpunim me OSHMA-të të rrisin përpjekjet për një zgjidhje alternative të pranueshme dhe më pak të kushtueshme për periudhën kalimtare, siç mund të jetë titrimi.

8. AMA, duke pasur parasysh rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi, pas finalizimit të lirimit të brezit DD2, të iniciojë menjëherë procesin e rishikimit të tarifave të mbështetjes duke kërkuar nga operatori publik rishikimin e tyre, në mënyrë që këto tarifa të jenë proporcionale dhe jodiskriminuese.

9. AMA të luajë një rol proaktiv në propozimin e ndryshimeve të nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për reklamat publike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

10. AMA, gjatë procesit të hartimit apo ndryshimit të kuadrit nënligjor, të ketë në vëmendje mbështetjen dhe lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve në fushën audio/audiovizive, si dhe rritjen e transparencës së rregullatorit.

11. AMA t'i kushtojë vëmendje monitorimit të portaleve dhe faqeve online që hapen nga media të ndryshme audiovizive; fenomeni i denigrimit që iu bëjnë personave të ndryshëm këto portale apo media është shumë shqetësues.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 6.7.2023.